



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 742/5 Prot.

Tiranë, më 21/11/2013

Lënda: Urdhër për Kontrolluesin “Noshi Rent Shpk”, Tiranë.

U R D H E R

Nr 23, datë 21/11/2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit “Noshi Rent Shpk”, Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrimit nr. 124 datë 03.07.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye inspektimi administrativ pranë kontrolluesit “Noshi Rent Shpk” me adresë, Rr. e Durrësit, Nr. 79, pranë Ambasadave, Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri.

Objekti i Kontrollit administrativ ishte:

- Respektimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale (klientëve);
- Koha e ruajtjes së të dhënave personale të klientëve;
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

Nga kontrolli administrativ i zhvilluar, rezulton se kontrolluesi “Noshi Rent sh.p.k.” gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij privat në fushën e dhënies me qera të automjeteve, mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë “klientë”.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, pretendimet e kontrolluesit, si dhe provat e administruara vëren se:

- Kontrolluesi “Noshi Rent sh.p.k.” respekton të drejtat e subjekteve të të dhënave personale “klient”, në përputhje me nenet 12-17 të ligjit 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se kontrolluesi i ka marrë masat dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me të drejtat e subjekteve të të dhënave personale (klientët) për të aksesuar, korigjuar dhe fshirë të dhënat e tyre personale. Gjithashtu vlerëson angazhimin e kontrolluesit që në formatin bashkëlidhur kontratës së qerasë, ku parashikohen termat dhe kushtet, të parashikojë një dispozitë mbi detyrimin e kontrolluesit për të respektuar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale (klientëve) në referim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Të dhënat personale të klientëve mbahen në dosje dhe në kompjuter për një afat të pacaktuar.

Komisioneri vlerëson se mbajtja e të dhënave personale për një afat të pacaktuar bie në kundërshtim me shkronjën d) të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, në të cilin theksohet fakti se të dhënat personale nuk duhet të mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar (Parim i përgjithshëm i cili vlen në rastet kur nuk janë përcaktuar afate specifike nëpërmjet akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri). Duke qenë se qëllimi i mbledhjes dhe përpunimit lidhet me marrëdhënien kontraktore të qerasë së automjeteve, atëherë nga momenti i përfundimit të kësaj marrëdhënieje përfundon afati i mbajtjes së të dhënave dhe ato duhet të fshihen nga kompjuteri, ndërsa dokumentet shkresore të shkatërrohen. Mundësia e vetme ligjore për të mundësuar mbajtjen më tej të të dhënave personale është marrja e pëlqimit të klientëve në formë shkresore.

- Në kuadër të mbrojtjes së sigurisë së të dhënave personale të klientëve dhe ruajtjen e konfidencialitetit (neni 27, 28), Komisioneri konstaton se:

- 1) Kontrolluesi i ka marrë të gjitha masat e sigurisë fizike të ambienteve dhe siguron një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje për dokumentat e administruara në dosjet e klientëve. Të dhënat e administruara në kompjuter aksesohen vetëm nga administratori i kompanisë dhe dy punonjës të tjerë, të cilët janë të pajisur me "emër përdoruesi" dhe "fjalëkalimin" përkatës.
- 2) Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme për sigurinë e të dhënave personale që përpunon për qëllime të ushtrimit të aktivitetit (detyrim i parashikuar në Udhëzimin nr.22, datë 24.09.2012 për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë të të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël").
- 3) Personat që kanë akses në të dhënat personale të klientëve, nuk kanë nënshkruar një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale. Në kontratat e tyre të punës nuk parashikohet asnjë detyrim lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale të klientëve.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

U R D H E R O J

1. Në zbatim të shkronjës d) të nenit 5 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të dhënat personale të klientëve, të administruara në kompjuter dhe në dosje fizike, me të cilët ka përfunduar marrëdhënia kontraktore, të fshihen ose të shkatërrohen, pasi mbahen për një afat që e tejkalon qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar;
2. Në zbatim të nenit 6/1/a dhe nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të mblidhen dhe përpunohen vetëm të dhënat personale për të cilat është dhënë paraprakisht pëlqimi i informuar (në formë shkresore) i subjektit të të dhënave (klientit);
3. Në zbatim të nenit 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar:
 - Të hartohet një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit. Në të duhet të parashikohen masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
 - Personat që kanë akses në të dhënat personale të klientëve, duhet të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 40 (dyzetë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë urdhër;
5. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
6. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit: “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

